



Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar

MESAZH NGA DREJTUESIT E PROGRAMIT AASF

Ndërsa këtij viti të pazakontë që lamë pas i erdhi fundi, ekipi i AASF dëshiron të falënderojë të gjithë partnerët e tij dhe palët kryesore të interesit, për përpjekjet e tyre, bashkëpunimin dhe nivelin e lartë të fleksibilitetit të treguar gjatë zbatimit të projektit të AASF përgjatë vitit 2020. Ne, si Program do të vazhdojmë të mbështesim agrobizneset shqiptare dhe Institucionet Financiare Partnere për të financuar këtë sektor jetësor të ekonomisë shqiptare me potencial gjerësisht të pashfrytëzuar - bujqësinë dhe agrobizneset.

Ne jemi të sigurt që ky vit do të ofrojë një kthim prapa në normalitet duke përfshirë industrinë e agrobiznesit dhe bujqësinë në përgjithësi si sektor i rëndësishëm për vendin.

Në vijmë, kemi kënaqësinë të ndajmë me ju buletin tonë të pestë të "Programit të Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar", i cili synon shkëmbimin e informacionit në lidhje me aktivitetet e fundit dhe ato të ardhshme të Programit. Ashtu si AASF, ky buletin u drejtohet aktorëve dhe palëve të interesuara, bankave dhe institucioneve mikro-financiare, fermerëve, sipërmarrësve dhe kompanive dhe individëve të angazhuar në bujqësinë vendase, për shembull si prodhues, përpunues, tregtar të pajisjeve bujqësore ose ofrues shërbimesh.

Në këtë botim të ri, ju do të gjeni një përmbledhje të aktiviteteve tona gjatë muajve të fundit. Ndërtimi dhe përmirësimi i marrëdhënieve midis institucioneve financiare dhe agrobiznesit, organizimi i takimeve përmes konferencave elektronike dhe webinarëve me palët kryesore të interesit, duke synuar mundësimin e të kuptuarit më të mirë mbi nevojat dhe sfidat e agrobizneseve dhe promovimin e produkteve dhe botimeve të AASF. Më

tej, ne do të prezantojmë "Kampionët e AASF", histori suksesi në lidhje me agrobizneset që kanë përfituar nga lehtësitë mbi përmirësimin e prodhimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të sektorit bujqësor shqiptar, si dhe do t'ju njohim me disa aktivitete kryesore të palëve të interesit dhe mbulimin mediatik rreth veprimtarisë së AASF.

Mezi presim të ndajmë me ju arritjet e ardhshme të AASF-së.

Deri në takimin e ardhshëm, ju urojmë një vit të mbarë dhe të begatë përpara!

Adela Leka
Drejtuese e Programit, AASF

SHTYLLAT KRYESORE TË PROJEKTIT

Mbulimi i Riskut të Parë të humbjeve ("FLRC")

Mbulimi i Riskut të Parë të humbjeve ("FLRC") - është një mekanizëm që shërben për rritjen e kreditimit i siguruar nga Qeveria e Shqipërisë, duke mbuluar 20% të humbjeve të shumës totale të nën-kredive të financuara me të ardhurat nga Linja e Kredisë së Agrobiznesit ose nga Shpërndarja e Riskut.



Lehtësitë e Shpërndarjes së Riskut të Agrobiznesit

Lehtësitë e Shpërndarjes së Riskut të Agrobiznesit, bazohet në pjesëmarrje në portofolin e pafinancuar, si një instrument i cili mbulon deri në 50% të shumës agregate të portofolit të nën-kredive të Agrobiznesit.

Linjat e kreditimit të agrobiznesit

si linjat e kredisë jo të siguruar për Institucionet Financiare Partnere në Shqipëri në financimin e subjekteve të agrobiznesit për investime afatmesme dhe afatgjata.



Asistencë Teknike

- a) Ndërtimi i kapaciteteve të Institucioneve Financiare Partnere
- b) Asistencë teknike specifike të sektorit të agrobiznesit.

01 Webinare të Programit


Muajt e fundit, AASF ka organizuar dhe ka marrë pjesë në një sërë webinarësh të fokusuar në sfidat dhe mundësitë e agrobiznesit në Shqipëri.



Kjo platformë komunikimi ka rezultuar e dobishme dhe efektive në prezantimin e palëve të interesuara dhe bashkëpunëtorëve të programit me informacione të rëndësishme dhe studimeve empirike mbi sfidat dhe potencialet e zhvillimit të produkteve sezonale gjatë periudhës së pandemisë. Më tej këto webinarë kanë mundësuar paraqitjen e një panorame mbi mundësitë për investim për fermerët dhe agrobizneset shqiptare. Në nëntor, në bashkëpunim me Programin e BERZH, Këshilla për Bizneset e Vogla (ASB), AASF organizoi një webinar me fokus nxitjen e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të Agroturizmit përmes Institucioneve Financiare Partnerë të AASF (PFI), duke prezantuar pjesëmarrësit me potencialin në rritje, mekanizmat e disponueshëm të mbështetjes financiare dhe asistencën teknike për këtë sektor.




Ndërsa në dhjetor, AASF në bashkëpunim me ASB dhe RISI Albania u organizua një webinar me temë: "Agrobiznesi në Shqipëri: Nga Çertifikimet tek Kontraktimi Bujqësor". Fokus i këtij webinarit ishte promovimi i çertifikimeve ndërkombëtare në sektorin e agrobiznesit si dhe diskutime mbi rëndësinë e bujqësisë me kontratë si dhe prezantimi me praktikat më të mira të bujqësisë sipas standardeve ndërkombëtare (Global GAP).



Në vijim Programi AASF ka vijuar me zhvillimin e webinarëve të tjerë, siç kanë qënë ato për bashkëpunimin me skemën IPARD, duke synuar të ndihmojë në informimin dhe nxitjen e rritjes së disburimeve të kësaj skeme dhe Programit AASF, si dhe orientimin e klientëve të mundshëm drejt Institucioneve Financiare Partnerë të AASF.

Këto seri webinarësh kanë tërhequr një numër të madh pjesëmarrësish nga sektorë dhe profesione të ndryshme, përfshirë ekspertët teknikë të AASF, përfaqësues nga Qeveria Shqiptare dhe BERZH, donatorë të tjerë, Institucionet Financiare Partnerë të AASF (Intesa SanPaolo, ProCredit Bank, Raiffeisen Bank, OTP Bank dhe Fondi Besa), Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë, agrobizneset e interesuara dhe institucionet shtetërore që përfaqësojnë sektorin bujqësor.

AASF do të vazhdojë të organizojë dhe marrë pjesë në webinarë të tjera në të ardhmen, duke promovuar studime të reja lidhur me impaktin Covid-19 në produktet sektoriale në Shqipëri. Për të parë videot e plota të ciklit të webinarëve tona, ju lutemi vizitoni faqen tonë: [Albania Agribusiness Support Facility](#)



"Programi i BERZH Këshilla për Bizneset e Vogla ofron më shumë sesa thjesht mundësi të mbështetjes financiare për agrobizneset. BERZH ofron këshilla biznesi për bizneset e vogla dhe të mesme, duke përfshirë hartimin e planit të biznesit, marketingut, menaxhimit financiar, burimet njerëzore dhe standardet e sigurimit të cilësisë në fazën përgatitore." - Ardiola Hristic, Menaxhere Programi, BERZH, Këshilla për Bizneset e Vogla.

02 Prezenca Mediatike

Ekspertët e Lartë të AASF kanë qënë të angazhuar në mënyrë aktive në diskutime mediatike e publike rreth sfidave dhe mundësive të fermerëve dhe ndërmarrjeve të agrobiznesit në Shqipëri.

Z. Ilir Pilku, Ekspert i Lartë i Agrobiznesit pranë AASF, ka marrë pjesë në disa programe televizive për të diskutuar rreth studimeve më të fundit të AASF mbi produktet sezonale si dhe për të folur në lidhje me bashkëpunimin tonë me IPARD në funksion të përfitimeve që kjo skemë i sjell agrobiznesit. Z. Pilku i ka ofruar publikut një panoramë të gjerë rreth produkteve bujqësore sezonale bazuar në studimet sektoriale të AASF mbi



efektin e Covid-19 në kultivimin e rrushit të tavolinës. Më tej, ekspertët kanë njohur agrobizneset dhe biznesin e agroturizmit shqiptar me mundësinë dhe përfitimet që mund të gjejnë tek programi i AASF dhe bashkëpunimi me IPARD apo skemat e tjera kombëtare. AASF dhe ekspertët e tij vazhdojnë të kontribuojnë në nxitjen e debatit publik dhe shpërndarjen e gjetjeve

të produkteve dhe studimeve sektoriale duke tërhequr vëmendjen dhe interesin e Institucioneve Financiare dhe biznesit agro në përgjithësi.

Për më shumë informacion ju lutemi të ndiqni faqen tonë zyrtare në: [The Albania Agribusiness Support Facility \(AASF\)](#).

Paralelisht, AASF ka bashkëpunuar fuqimisht si me Qeverinë e Shqipërisë ashtu edhe me BERZH, për të promovuar IPARD. Skemat Kombëtare të Granteve dhe asistencën teknike të ASB, si dhe të gjitha instrumentet për shpалosjen e potencialit të sektorit të agrobiznesit. Në të njëjtën kohë, duke mbuluar rrezikun e parë të humbjes nga programi, falë mundësisë që programi ofron, Institucionet Financiare Partnerë kanë financuar më shumë plane biznesi të agrobizneseve.

03 Publikime

Ekspertët e AASF kanë monitoruar vazhdimisht ndikimin e pandemisë në industrinë e bujqësisë në Shqipëri dhe kanë zhvilluar disa studime në lidhje me "Efektet Covid-19 në produktet sezonale bujqësore". Studimi i fundit ofron një pasqyrë të situatës mbi efektet e Covid-19 në kultivimin e rrushit dhe zinxhirin e vlerës së verës në Shqipëri, duke nisur me prezantimin e potencialit të këtij produkti por edhe të sfidave lidhur me pandeminë në drejtim të prodhimit dhe tregtimit të rrushit gjatë sezonit.

Studimi përqendrohet në ndikimin e pandemisë në segmente të ndryshme të zinxhirit të vlerës bujqësore dhe nxjerr në pah implikimet për Institucionet Financiare dhe klientët e tyre të agrobiznesit. Më



tej, studimi prezanton mekanizmat mbështetës dhe strategjitë e zbutjes së rrezikut për të përballuar situatën dhe forcuar qëndrueshmërinë e bizneseve dhe PFI-ve. AASF ka mundur gjithash-

tu botimin e njoftimeve dhe infografikëve të cilat kanë patur për qëllim njoftimin mbi thirrjen e tretë të IPARD me objektiv tërheqjen e përfituesve të mundshëm dhe të palëve kryesore të interesit, njëkohësisht duke shpjeguar edhe elementët e tyre mbi mundësitë e skemës të shpjeguara përmes masave të saj 1 dhe 3 për investimet për agrobizneset në Shqipëri.

Për të lexuar studimet e plota lutemi vizitoni faqen tonë zyrtare: www.aasf.com.al

"Programi AASF synon të arrijë objektivat e saj përmes mbështetjes së Institucioneve Financiare Partnere (PFI) dhe agrobizneseve duke ofruar studime dhe botime empirike, organizuar aktivitete dhe fushata rrjetëzimi, apo përmes ofrimit të trajnimeve dhe njohurive teknike".

KAMIPIONËT E AASF

"Kampionët e AASF" janë bizneset e zgjedhura, të cilat kanë marrë mbështetje teknike dhe financiare nën Programin e AASF që u mundëson atyre të rrisin produktivitetin, efikasitetin e burimeve ose shtimin e vlerës. Ata shërbejnë si shembuj modelit më të mirë përfaqësues, sesi AASF kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të sektorit bujqësor shqiptar.



Ilia Daka është pronar dhe administrator i një sere perimesh prej 8,7 hektarësh me vendndodhje në Salce, Kozare të Beratit. Ai përfitoi nga ndihma financiare përmes Programit të AASF dhe IPARD midis 2017 dhe 2020. Megjithatë ka 20 vjet përvojë pune në sektorin e bujqësisë, Z. Daka, mundi të investojë në agrobiznesin e tij vetëm në vitin 2017. Menjëherë ai njohu sukses dhe u gjend përpara kërkesës së tregut për produktin e tij, kështu që vendosi të zgjerojë biznesin.

Në vitin 2020 pasi fitoi një grant nga Skemat IPARD, ai ishte në gjendje të zgjeronte serën e tij të parë me një të dytë, të dedikuar për prodhimin e domateve.

"Për të rritur kapacitetin tonë të prodhimit, ne kemi ndërtuar një serë të re. Siç mund ta shihni, ky është investim i ri, i cili mundi

të finalizohet vetëm falë mbështetjes së AZHBR dhe mbështetjes financiare nga Intesa Sanpaolo Bank përmes programit të AASF. Këtu kemi mbjellë kryesisht domate dhe speca të cilat eksportohen. Prodhimi ka qenë i mjaftueshëm dhe me një cilësi shumë të mirë." – tha zoti Daka.



AASF dhe Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) e kanë mbështetur zotin Ilia Daka përmes ndihmës financiare dhe teknike për të zgjeruar kapacitetet e tij prodhuese dhe për të ofruar një shërbim më cilësor për klientët e tij. Vetëm përmes AASF, agrobiznesit iu mundësua aksesin në kredi deri në 65 000 Euro dhe zgjerimi i prodhimit dhe shpërndarjes së produkteve të tij.

E themeluar në fillim të viteve 2010 si kompani transporti dhe tregëtie të mjeteve bujqësore, në Libofsh të Fierit, Tris Alb nis aktivitetin e saj blegtoral në vitin 2012. Ajo përfitoi nga asistenca financiare përmes AASF dhe skemës IPARD duke nisur nga viti 2019.

Përmes mbështetjes së Programit AASF dhe skemës së IPARD, "Tris Alb" arriti të bëhej përfituese e një granti prej 500 mijë euro çka i mundësoi asaj zgjerimin e kapaciteteve prodhuese përmes blerjes së makinerive dhe pajisjeve të teknologjisë së lartë si dhe shtimit të hapësirave të fermës. Gjithashtu klienti



zgjeroi ambientet e stallës dhe atyre mbështetëse.

Nëpërmjet Bankës Intesa Sanpaolo, bankë partnere e programit AASF, kompania përfitoi kredi me kushte preferenciale, e cila mbështeti në zgjerimin e aktivitetit. Duke përmbushur kriteret e selektimit si edhe të aksesit në financim pranë bankës Intesa Sanpaolo, kompanisë iu mundësua të realizonte me sukses investimet si edhe të përfitonte nga grantet e skemës së IPARD-it.

Si rezultat sot kompania punëson 23 individë me kohë të plotë dhe 15 të tjerë sezonal, numëron 570 lopë dhe mëshqerra dhe mbi 340 viça si dhe ka rritur kapacitetet e saj prodhuese me 17 herë duke arritur të prodhojë rreth 12,000 litra qumësht në ditë.

Sot janë më shumë se 6000 fermerë dhe agrobiznese në Shqipëri që kanë përfituar nga "Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar" (AASF).

Edhe pse ky vit ka qenë sfidues për nga impakti i pandemisë globale të koronavirusit, ekipi ynë ka vazhduar të përmbushë detyrat dhe rolin e tij për të gjetur mënyra të reja komunikimi me klientët dhe mundur studime të cilat kanë mbështetur industrinë bujqësore në përpjekjet e saj për të kaluar impaktin ekonomik.

PARTNERËT TANË

Raiffeisen Bank

Raiffeisen Bank është një nga bankat më të mëdha në vend dhe gjatë 14 viteve të fundit ka shndërruar plotësisht Bankën e vjetër të Shtetit në një bankë me shërbim të plotë që shërben për të gjithë sektorët e biznesit dhe tregjet private individuale. Banka ka një gamë produktesh, procesesh, sistemesh dhe një infrastrukturë degësh që krahasohet në mënyrë të favorshme me standardet evropiane të shekullit XX. Raiffeisen Bank ofron gamën e plotë të produkteve dhe shërbimeve bankare në 4 sektorët kryesorë të biznesit në të cilët operon - individë privatë, mikro biznes, biznes të vogël dhe biznes korporative dhe u shërben më shumë se 800,000 klientëve. Raiffeisen Bank mbështet agrobiznesin dhe fermerët në çdo aktivitet të biznesit të tyre përkundër madhësisë dhe pozicionit të tij në industri. Si çdo hua tjetër, edhe kjo është e strukturuar duke u bazuar në ciklin e biznesit bujqësor.

Link: <https://www.raiffeisen.al/>



Pro Credit Bank

ProCredit Bank është një bankë tregtare e orientuar drejt zhvillimit. Banka ofron shërbim të shkëlqyeshëm për klientët, për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme dhe për individët privatë që kanë aftësinë për të kursyer dhe që preferojnë të kryejnë veprimet e tyre bankare përmes kanaleve elektronike. Fokusi i tyre është tek ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, pasi janë të bindur se këto biznese krijojnë vende pune dhe japin një kontribut jetik për ekonominë në të cilat operojnë. Një nga strategjitë kryesore për huadhënien është mbështetja e klientëve që merren me prodhim dhe bujqësi.

Link: <https://www.procreditbank.com.al/>



Intesa San Paolo

Intesa Sanpaolo Bank është një nga bankat më të mëdha në vend që ofron një gamë të gjerë zgjidhjesh financiare, produkte dhe shërbime novatore për klientët e korporatave, klientët privatë institucionalë dhe me të ardhura të larta, si dhe bizneset e vogla dhe të mesme dhe klientët individualë. Intesa Sanpaolo Bank Albania ka një rrjet prej 35 degësh në qytete të ndryshme të vendit dhe po zgjerohet më tej strategjikisht në të gjithë Shqipërinë. Risia dhe përsosmëria e shërbimeve në Intesa Sanpaolo Bank Albania janë frymëzuar nga klientët e saj. Një nga strategjitë e Bankës Intesa Sanpaolo në Shqipëri është zgjerimi i portofolit të saj në agrobiznes, duke mbështetur posaçërisht bizneset e vogla dhe fermerët me zgjidhje financiare të përshtatura.

Link: <https://www.intesasanpaolobank.al/>



AZHBR

Agjencia e Zhvillimit Bujqësor dhe Rural (AZHBR) është një agjenci kombëtare shtetërore që synon të mbështesë sipërmarrësit shqiptarë në sektorin e bujqësisë dhe ushqimit, duke përgatitur institucionin të përfitojë nga fondet e BE-së dhe donatorëve të tjerë. AZHBR po mbështet sektorin drejt ristrukturimit, modernizimit dhe specializimit në produkte dhe tregje specifike bazuar në avantazhet konkurruese të vendit. AASF është që prej vitit 2016 duke bashkëpunuar me AZHBR për të mbështetur fermerët dhe agrobiznesin në Shqipëri përmes ndihmës teknike dhe mbështetjes financiare.

(W): <http://www.azhbr.gov.al/>



Otp Bank

OTP Bank si një lojtar dominues bankar në Hungari dhe rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore ofron shërbime financiare me cilësi të lartë për më shumë se 18.5 milion klientë privatë dhe korporata në nëntë vende përmes pothuajse 1500 degëve të saj, rrjeteve të agjentëve, 3900 ATM-ve, kanaleve të internetit dhe elektronike. Zhvillimi dhe zgjerimi i vazhdueshëm i OTP Bank ka kontribuar ndjeshëm në funksionimin e suksesshëm dhe efikas të grupit bankar, i cili ofron shërbime me cilësi të lartë si për klientët me pakicë ashtu edhe për institucionet. Megjithë konkurrencën e fortë, pozicioni i tregut të OTP Bank është i qëndrueshëm në disa segmente, si dhe përsa i përket përfitimit dhe stabilitetit, banka i takon vijës evropiane. Ndonëse OTP Bank është një lojtar i ri në tregun bankar shqiptar, sektori i agrobiznesit është një nga segmentet kryesore të synuara për mbështetjen e tyre financiare.

Link: <https://otpbank.al/>



Fondi Besa

Fondi Besa, me 80 zyra në të gjithë Shqipërinë, synon të jetë i pranishëm aty ku ka nevojë për zhvillim, duke ofruar mundësi aksesimi për mijëra njerëz, përmes mbështetjes me shërbime financiare, krijimit të lidhjeve midis klientëve dhe mundësive për të kontribuar në zhvillimin më të mirë ekonomik të vendit.

(W): <https://fondibesa.com/>



AASF

(E): info@aasf.com.al
(W): www.aasf.com.al

Na ndiqni në grupin tonë të LinkedIn:

The Albania Agribusiness
Support Facility (AASF)